

VENDIM
Nr. 24, datë 11.5.2018

PËR DHËNIEN E MANDATIT
TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU TIRANË, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 11.5.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar
Denar Biba	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysen Osmanaj	anëtar
Vera Shtjefni	Anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Saimir Bashkim Tahiri.

Kërkuesi: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Nëpërmjet shkresës nr. 1570/1 prot., datë 7.5.2018, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit z. Saimir Bashkim Tahiri, deputet i zonës zgjedhore, qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një), znj. Elona Shpetim Hoxha/Gjebrea; me numër rendor 2 (dy), z. Besnik Mitat Baraj; me numër rendor 3 (tre), znj. Olta Anxhelo Xhaçka; me numër rendor 4 (katër), znj. Blerina Guri Gjylameti; me numër rendor 5 (pesë), z. Pandeli Sotir Majko; me numër rendor 6 (gjashtë), z. Saimir Bashkim Tahiri; me numër rendor 7 (shtatë), znj. Vasilika Llambi Hysi; me numër rendor 8 (tetë), z. Ervin Alfred Bushati; me numër rendor 9 (nëntë), znj. Ogerta Dhionis Manastirliu; me numër rendor 10 (dhjetë), z. Fatmir Sezai Xhafaj; me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), z. Rakip Bajram Suli; me numër rendor 12

(dymbëdhjetë), z. Arben Novruz Ahmetaj; me numër rendor 13 (trembëdhjetë), z. Xhemal Myslim Qefalia; me numër rendor 14 (katërbëdhjetë), z. Sadri Ismail Abazi; me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë), z. Ulsi Qerim Manja; me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), znj. Klotilda Fatmir Bushka; me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), z. Sadi Mehdi Vorpsi; me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Arben Servet Pëllumbi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë.

Në bazë të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Spartak Brahim Braho.

Referuar nenit 11, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Spartak Brahim Braho, referuar ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 8.5.2018, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2057.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Spartak Brahim Braho, rezulton se:

- Në pikën "B" të formularit të vetëdeklarimit, "Gjenealitete të mëparshme", ka deklaruar se: ka ndryshuar emrin nga "Zylyftar" në "Spartak" (ndryshuar rreth vitit 1957, si dhe nuk mbahet mend viti i saktë, si dhe akti i ndryshimit të gjendjes civile);

- Në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit, "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?" është përgjigjur me "Po", duke deklaruar, se me vendimin nr. 1397, datë 22.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënuar për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2, Kodi Penal të Kohës dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit me gjobë në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë;

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 792 prot., datë 9.5.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe, me shkresën nr. 790 prot., datë 9.5.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Spartak Brahim Braho, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. 1206/1 prot., datë 10.5.2018, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Spartak Brahim Braho, sipas së cilës rezulton se me vendimin nr. 1397, datë 22.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2 e Kodi Penal, dënuar me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë. Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e e vetëdeklarimit, të z. Spartak Brahim Braho dhe informacionit të ardhur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore Tiranë, rezulton se dënimi me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë, pasi është deklaruar fajtor për veprën penale “Shpifje”, parashikuar nga neni 120/2, i Kodit Penal, me vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Spartak Brahim Braho.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe në nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, z. Spartak Brahim Braho.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri